

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2023**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2023

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar në mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore	Totali i likuiditetit të injektuar
6-korrik-23		37.74			53.66
13-korrik-23		41.51			57.42
20-korrik-23		40.66			56.58
21-24 korrik-23	3.58				60.16
24-korrik-23			8.08		60.25
27-korrik-23		28.62			48.21
3-gusht-23		25.48			45.07
10-gusht-23		26.72			46.31
17-gusht-23		27.51			47.10
18-21 gusht-23	2.67				49.77
22-gusht-23	2.74				49.84
23-gusht-23	3.59				50.69
24-gusht-23		41.19	4.39		60.75
31-gusht-23		36.30			55.86
7-shtator -23		27.75			47.31
14-shtator -23		41.26			60.82
21-shtator -23		45.98			65.54
24-shtator -23			7.23		65.67
28-shtator -23		41.55			61.23

Në tremujorin e tretë të vitit 2023, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë është rritur më tej në 54.20 miliardë lekë kundrejt 44.65 miliardë lekë mesatarisht në gjashtë muajt e parë të vitit 2023. Mungesa është në nivelet maksimale të vërejtura dhe mbi limitin e sipërm të tolerancës së Bankës së Shqipërisë. **Mungesa ka qenë e qëndrueshme në nivele të larta mbi 45 miliardë lekë, duke shënuar vlerën 56.30 miliardë lekë në fillim të periudhës dhe 61.20 miliardë lekë në fund të saj.**

Duke synuar uljen e mungesës nëpërmjet arritjes së mesit të bandës së synuar për madhësinë e portofolit, Banka e Shqipërisë ka vijuar të organizojë ankande të blerjes së letrave me vlerë, por pjesëmarrja e bankave ka qenë e ulët për shkak të trendit rënës së yeldeve në ankandet e tregut primar dhe riklasifikimin e letrave me vlerë në hold to maturity gjatë vitit 2022 prej bankave të nivelit të dytë.

Faktori kryesor i stabilizimit të mungesës në nivele të larta dhe më pak në rritjen e tij ka qenë akumulimi i likuiditetit në llogarinë e qeverisë në muajt e mëparshëm, ndërkohë që në pjesën e parë të periudhës, MFE ka ndikuar në uljen e mungesës, ndërsa në pjesën e dytë në rritjen e saj. Gjatë periudhës, gjendja në llogarinë e qeverisë ka rënë me 1.1 miliardë lekë, por janë paguar në Bankën e Shqipërisë marrëveshje SWAP për 4.47 miliardë lekë në 18 shtator.


Paraja në qarkullim është rritur me 4.07 miliardë lekë, ku vetëm në muajin korrik u regjistrua një rritje me 5.56 miliardë lekë. Në periudhën qershor-korrik, rritja e parasë në qarkullim ka qenë 10.63 miliardë lekë, duke bërë që shenjat e mëparshme të një ecurie më pozitive të këtij faktori në kushtet e normave të interesit më të larta, të zhbëhen gjatë këtij tremujori.

Faktorë me ndikimin pozitiv në likuiditetin e bankave kanë qenë blerjet e valutës nga bankat e nivelit të dytë për në total 9.73 miliardë lekë.

Në funksion të operacioneve për administrimin e likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë, ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor për mesatarisht 35.56 miliardë lekë ose 65.60% kundrejt përkatësisht 68% dhe 64% në tremujorin e mëparshëm.

Rastet e përdorimit të kredisë njëditore kanë rënë gjatë periudhës në 9 prej 13 në tremujorin e dytë dhe 20 në tremujorin e parë, ndërsa përdorimi i instrumentit të depozitës njëditore ka rënë në mesatarisht 400 milionë lekë.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2022 (me vlerë nominale)
Burimi: Banka e Shqipërisë.




1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme

Sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës në BSH për shumën maksimale 3.4 miliardë kundrejt maksimalisht 17.70 miliardë lekë në periudhën e mëparshme.

1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit tretë të vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka vijuar të tentojë rritjen e portofolit nëpërmjet ankandëve të blerjes së letrave me vlerë. Vlera e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë është 69.45 miliardë lekë, pranë niveleve maksimale të vërejtura, por në terma relativë kundrejt borxhit publik të emetuar në monedhën kombëtare, madhësia e portofolit është nën 10% kundrejt rreth 25% në fillim të viteve 2000.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023



1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës janë zhvilluar operacione rregulluese në fund të RD në muajin korrik për shumën 4 miliardë lekë dhe në muajin gusht për 3 ditë në 3-4 miliardë lekë. Bankat pjesëmarrëse kanë qenë dy në muajin korrik dhe katër në muajin gusht.

2. NDËRHJRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2023

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të tretë të vitit 2023, sikurse lajmëruar në 13 dhjetor 2022 dhe rishikuar në datën 3 gusht 2023, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar pesë ankande për blerjen e valutës, një prej të cilëve ka qenë me opsionin forward.

Në ankandet e zhvilluara janë blerë 66.50 milionë Euro ku në dy prej tyre është blerë shuma maksimale e mundshme prej 18 milionë Euro.

Rezultatet e detajuara të të gjitha ankandëve të zhvilluara nga Banka e Shqipërisë, mund t'i gjeni në link-un:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2023			
	Data	Shuma Raundi I (ne euro)	
1	2/17/2023	5-9 mln	1 mo FW
2	3/17/2023	5-9 mln	1 mo FW
3	4/11/2023	5-9 mln	1 mo FW
4	4/20/2023	5-9 mln	
5	5/11/2023	5-9 mln	
6	5/26/2023	5-9 mln	
7	6/9/2023	5-9 mln	
8	6/21/2023	5-9 mln	1 mo FW
9	7/6/2023	5-9 mln	
10	7/20/2023	5-9 mln	
11	8/4/2023	5-9 mln	
12	8/18/2023	5-9 mln	1 mo FW
13	9/22/2023	5-10 mln	
14	10/18/2023	5-10 mln	1 mo FW
15	11/17/2023	5-10 mln	1 mo FW
16	12/6/2023	5-10 mln	
17	12/20/2023	5-10 mln	1 mo FW

** Ne rastet kur ankandi bie ne dite pushimi, ankandi do te organizohet ne ditën pasardhese te punës.*

Gjatë vitit 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandëve 220-300 milionë Euro.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, MFE ka maturuar marrëveshjen SWAP për 4.47 miliardë lekë pas maturimit për 8.94 miliardë lekë në tremujorin e parë dhe 4.7 miliardë lekë në tremujorin e dytë. Marrëveshjet e SWAP të pamaturuara paraqiten si më poshtë:

1. 40 milionë Euro në 20 tetor 2023;
2. 45 milionë Euro në 17 nëntor 2023.